**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

Nr. ______ prot                                                                 Datë 03.09.2021

**Drejtuar**: "INFINIT" Sh.p.k, adresa: Korçë Udenisht MEMLISHT Fshati Memelisht, poligoniparafabrikat Guri i Kuq, ambjent me numer pasurie 731/45, zona kadastrale 2648

**Procedura e prokurimit**/lotit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me mjete elektronike

**Numri i procedurës / referenca e Lotit**: REF-03347-08-20-2021

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** "Ndërtim rrjeti kanalizimesh për ujrat e përdorura tek ish Gjeologjia Korçë, si dhe instalime hidro sanitare tek ish Gjeologjia Korçë dhe në fshatin Mborje, për shtresat në nevojë.” , me kohëzgjatje 21 dite kalenarike, duke filluar nga data e nënëshkrimit të kontratës
Publikimet e mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 130 datë 30.08.2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:
oferta ekonomikisht ☐ më e favorshme bazuar ne kosto
oferta ekonomikisht x☐ më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. ”INFINIT” Sh.p.k, NIPT: J74304623M, vlera: 1.634.903 (njëmilionegjashtëqindetridhjetë ekatërmijëenëntëqindetre) lekë.
2. ”VASHTEMIA” Sh.p.k, NIPT: J64103054Q , vlera: 1.674.277,5 (njëmilionegjashtëqinde shtatëdhjetëekatërmijëedyqindeshtatëdhjetëeshtatëpresjepesë) lekë.
3. ”SARK” Sh.p.k, NIPT: K52531415H, vlera: 1. 688.907 (njëmilionegjashtëqindetetë dhjetëetetëmijëenëntëqindeshtatë) lekë.
4. "GRAMA" Sh.p.k, NIPT: J77304712J, vlera: 2.035.807 (dymilionetridhjetëepesëmijëetetë qindeshtatë) lekë.

**Nga pjesërmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:**

1. ” VASHTEMIA” Sh.p.k, NIPT: J64103054Q

   *Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*
2. ” SARK” Sh.p.k, NIPT: K52531415H

   *Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*
3. ” GRAMA” Sh.p.k, NIPT: J77304712J

   *Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

➢ Lidhur me operatorin ekonomik "**VASHTEMIA**" Sh.p.k, mbështetur në Ligjin Nr.162/2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 82 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", KVO vendosi që ofertuesi "**VASHTEMIA**" Sh.p.k të mos kualifikohet sepse :

1. Ofertuesi nuk përmbush Kriterin e veçantë teknik të kualifikimit, pikën 2.2.1, të Shtojcës7të DT, për arsye se ofertuesi nuk ka paraqitur asnjëdëshmi për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashmetë kërkuar.
2. Ofertuesi nuk përmbush Kriterin e veçantë ekonomik, pikën 2.1.1, të Shtojcës7të DT, për arsye se ofertuesi nuk ka paraqitur vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2018, 2019, 2020.
3. Ofertuesi nuk përmbush Kriterin e veçantë teknik të kualifikimit, pikën 2.2.2, të Shtojcës7të DT, për arsye se ofertuesi nuk ka paraqitur licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë MIE/ ose MPPT/ ose MTI, për kategoritë N.P – 7 A; NP – 1 A dhe NS- 2 A.Lidhur me këtë , ofertuesi ka bërë vetëdeklarim tek Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit se ka "LICENCE NZ.0522/27", por nuk ka paraqitur asnjë dokument dokument konkret vërtetues.
4. Ofertuesi nuk përmbush Kriterin e veçantë teknik të kualifikimit, pikën 2.2.8, të Shtojcës7të DT, për arsye se ofertuesi nuk ka paraqitur certifikatë të vlefshme ISO 9001.Lidhur me këtë , ofertuesi ka bërë vetëdeklarim tek Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit se ka "*ISO 9001- 2015 (Sistemi i menaxhimit te cilesise)*", por nuk ka paraqitur asnjë dokument dokument konkret vërtetues.
5. Ofertuesi nuk përmbush Kriterin e veçantë teknik të kualifikimit, pikën 2.2.8, të Shtojcës7të DT, për arsye se ofertuesi nuk ka paraqitur certifikatë të vlefshme ISO *14001*.Lidhur me këtë , ofertuesi ka bërë vetëdeklarim tek Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit se ka "*ISO 14001-2015 (Sistemi i menaxhimit te mjedisit)*", por nuk ka paraqitur asnjë dokument dokument konkret vërtetues.
6. Ofertuesi nuk përmbush Kriterin e veçantë teknik të kualifikimit, pikën 2.2.8, të Shtojcës7të DT, për arsye se ofertuesi nuk ka paraqitur certifikatë të vlefshme ISO 45001.Lidhur me këtë , ofertuesi ka bërë vetëdeklarim tek Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit se ka "ISO 45001-2018 (Sistemet e menaxhimit tëshëndetit dhe sigurisë në punë)etj...", por nuk ka paraqitur asnjë dokument dokument konkret vërtetues.

➢ Lidhur me operatorin ekonomik "**SARK**" Sh.p.k, mbështetur në Ligjin Nr.162/2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 82 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", KVO vendosi që ofertuesi " SARK " Sh.p.k të mos kualifikohet sepse :

1. Ofertuesi nuk përmbush Kriterin e veçantë të kualifikimit, pikën 1.b , të Shtojcës 7 të DT, për arsye se Sigurimi i Ofertës i paraqitur nga ofertuesi me nr. serie 0136600 është i vlefshëm për 21 ditë dhe jo me periudhë vlefshmërie të ofertës 150 ditë sipas kërkesës të AK.

➢ Lidhur me operatorin ekonomik "**GRAMA**" Sh.p.k, mbështetur në Ligjin Nr.162/2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 82 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", KVO vendosi që ofertuesi "GRAMA " Sh.p.k të mos kualifikohet sepse :

1. Ofertuesi nuk përmbush Kriterin e veçantë teknik të kualifikimit, pikën 2.2.5, të Shtojcës 7 të DT, që përcakton se :

" Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/ të kualifikuar, si më poshtë:

a. Katër hidraulikë
b. Dy shtrues pllakash
c. Një Teknik të mesëm ndërtimi
d. Një punonjës manovrator të mjeteve të rënda
e. Dy punëtorë për gërmime me krahë

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit." ,

për arsye se ofertuesi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit që ka paraqitur , nuk ka deklaruar se disponon punonjësit e specializuar/ kualifikuar si më sipër, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatese, sipas formatit të Formularit :

Z. __________________________,me profesion________________, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e ____________________,.......................................

Lidhur me këtë, ofertuesi ka bërë vetëdeklarim tek Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit se ka 10 punonjës (sipas pikës 2.2.6) , por nuk ka deklaruar nëse disponon punonjësit e specializuar/ kualifikuar të kërkuar sipas pikës 2.2.5 .

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë "INFINIT" Sh.p.k, adresa: Korçë Udenisht MEMLISHT Fshati Memelisht, poligoniparafabrikat Guri i Kuq, ambjent me numer pasurie 731/45, zona kadastrale 2648, se oferta e paraqitur, me vlerë totale prej 1.634.903 (njëmilionegjashtëqindetridhjetëekatërmijëenëntëqindetre) lekë është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik´.

**Zyrtari i Autorizuar i Autoritetit Kontraktor**

**Elia Pendavinji**